








### 3.3 SHIRITI I MJETEVE

Ikonat në shiritin e mjeteve mundësojnë qasje të shpejtë në metodat e përdorura më shpesh. Përmbajtja e shiritit të mjeteve zakonisht nuk ndryshon. Mund të përzgjidhni dhe të përdorni vetëm metodat aktive. Metodatat joaktive kanë ngjyrë gri.

Në shiritin e veglave ndodhen këto ikona:

-  ikona për anulimin e veprimit të fundit, që është e barasvlershme me metodën **Redaktimi / Anulo**
-  ikona për rikthimin e veprimit të fundit, që është e barasvlershme me metodën **Redaktimi / Rikthe**
-  ikona për zhvendosjen e fushës ose nënfushës lartë që është e barasvlershme me metodën **Redaktimi / Zhvendos lart**
-  ikona për zhvendosjen e fushës përkatësisht nënfushës poshtë, që është e barasvlershme me metodën **Redaktimi / Zhvendos poshtë**
-  ikona për hapjen e dritares së kërkimit, që është e barasvlershme me metodën **Kërkimi / <akronimi i bazës lokale të të dhënave>/COBIB**
-  ikona për shfletimin e manualit për formatin COMARC, që është e barasvlershme me metodën **Pamja / Ndihma COMARC**
-  ikona për kontrollimin e regjistrimit, që është e barasvlershme me metodën **Regjistrimi / Verifiko regjistrimin**